

L I G J
Nr.7878, datë 30.11.1994

PËR PRISHJEN DHE KRIJIMIN E DISA MINISTRIVE

Në mbështetje të nenit 16, pika 13 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Presidentit të Republikës,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të prishen:

1. Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.
2. Ministria e Turizmit.
3. Ministria e Rendit Publik
4. Ministria e Punës, Emigracionit dhe e Përkrahjes Sociale.
5. Ministria e Transporteve.
6. Ministria e Industrisë dhe Tregtisë
7. Komiteti i ish-të Përndjekurve Politikë

Neni 2

Të krijohen:

1. Ministria e Ndërtimit dhe e Turizmit.
2. Ministria e Brendshme
3. Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë.
4. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe e ish-të Përndjekurve Politikë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.972, datë 3.12.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha